

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"THINKSMART A & C " SH.P.K

Sot, me date 18.11.2024(dymije e njezet e kater):

Egin Koçollari, i biri Stefanaq-it, i dtl.12.11.1983, lindur ne Tirane, banues ne Rrugen Mihal Grameno, pallati 1, shk.1, kati 5, Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, e pajisur me Karte ID Nr.personal I31112052M
Si themeluese te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosa të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet e më poshtëme:

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 'Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", redaktuan e këtij Akti Themelimi për themelimin e shoqërisë me Përgjegjesi te Kufizuar me emertimin **THINKSMART A&C SH.P.K**, me emrin tregtar Thinksmart – Audit & Consultancy Services me kushtet si më poshtë vijon:

NENI 1

Ortaku i vetem themelues i shoqerise është:

1. EGIN KOÇOLLARI.

NENI 2

Emërtimi

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqëria me Përgjegjesi te Kufizuar **THINKSMART A & C SH.P.K** me emrin tregtar Thinksmart – Audit & Consultancy Services.

NENI 3



Shoqëria e ka seline e saj ne adresen: Blv Gjergj Fishta, Pallatet Gora, Kulla Nr 2, Ap 18 1001,Tirane. Pervec ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit. Selia e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Përgjithshme.

NENI 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

NENI 5

Objekti i Veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Auditues Ligjor.Kryerja e Sherbimeve te auditimit dhe e sherbimeve te tjera te dhenies se sigurise, te sherbimeve te lidhura, sipas percaktimit te ketyre sherbimeve te dhena nga IFAC (Federata Nderkombetare e kontabilistev). Kryerja e Sherbime te kontabilitetit. Sherbimet e mbajtjes se kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ngritja, permiresimi dhe mirembajtja e sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendeshem te njesive ekonomike si dhe trajnimin profesional te personelit qe eshte ngarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve. Pergatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave te drejtuesve te biznesit. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale. Pergatitjen e planeve te biznesit per nevojat e drejtuesve dhe per palet e treta, rivleresim asetesh dhe vleresim aktivitetesh, keshillime biznesi mbi mundesite e zhvillimit, keshillime per fillim aktiviteti tregtar ,vleresime mbi vleren e aktivitetit, etj. Konsulenca fiskale, per njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Sherbime te tjera te lidhura me shoqerite tregtare, si: ndarje, bashkim, perthithje etj; rritje dhe zvogelim kapitali etj. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bëjnë pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 6

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njqind mije) lek dhe 1 kuote te zoteruara prej ortakut, si me poshte:



1. EGIN KOÇOLLARI,

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
EGIN KOÇOLLARI,	100%	1	100,000 (njqind mije Lek)

Kapitali themeltar është tërësisht në para. I gjithe kapitali themeltar është nënshkruar krejtësisht nga ortaku themelues.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 7

Administrator i vetëm dhe i pare i shoqërisë do të jete **Z. Egin Koçollari**, i cili ushtron edhe ndjek aktivitetin e shoqërisë, duke zbatuar edhe kompetencat perkatese sipas dipsozites perkatese te statutit.

NENI 8

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

NENI 9


Dispozita e fundit

Ky akt themelimi është perpiluar në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

Ortaku pasi lexoi dhe kuptoi përmbajtjen e këtij Akti Themelimi, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë nënshkruan si më poshtë.

ORTAKU THEMELUES

Egin Koçollari



STATUTI

I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“THINKSMART A & C ” SH.P.K

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Egin Koçollari, i biri Stefanaq-it, i dtl.12.11.1983, lindur ne Tirane, banues ne Rrugen Mihal Grameno, pallati 1, shk.1, kati 5, Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, e pajisur me Karte ID Nr.personal I31112052M

Si themeluesi kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosa të hartojë këtë Statut, mbështetur në parimet e më poshtëme:

KREU II

EMRI, STATUSI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar “THINKSMART A & C ” SH.P.K

me themelues EGIN KOÇOLLARI,

NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakja do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nënshkruara për kapitalin.

NENI 4

Shoqëria e ka seline e saj tek **Blv Gjergj Fishta, Pallatet Gora, Kulla Nr 2, Ap 18 1001, Tirane**. Me miratim te organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

KREU III

OBJEKTI

NENI 6

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Auditues Ligjor. Kryerja e Sherbimeve të auditimit dhe të shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC (Federata Ndërkombëtare e kontabilistëve). Kryerja e Sherbimeve të kontabilitetit. Sherbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ngritja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabel dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemeve. Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale. Përgatitjen e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për paletë të treta, rivelesim asetesh dhe vlerësim aktivitetesh, këshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, këshillime për fillim aktiviteti tregtar, vlerësim mbi vlerën e aktivitetit, etj. Konsulenca fiskale, për njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Sherbime të tjera të lidhura me shoqëritë tregtare, si: ndarje, bashkim, përthithje etj; rritje dhe zvogëlim kapitali etj. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bëjnë pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

KAPITALI

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lek i zotëruar prej ortakut, si më poshtë:

Emri	Përqindja	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
EGIN KOÇOLLARI	100%	1	100,000 (njëqind mijë Lek)

Kapitali themeltar është tërësisht në para. I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar krejtësisht nga ortaku themeluese.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8

KUOTAT E KAPITALIT

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

NENI 9

MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Kalimi dhe transerimi i kuotave është i kufizuar. Secili prej ortakëve gëzon të drejtën e parablerjes dhe mund të transferojë ose të shesë tërësisht ose pjesërisht kuotat e veta vetëm duke ja ofruar fillimisht kuotat e destinuar për shitje, ortakëve të tjerë të shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do t'i ofronte një personi të tretë. Nëse e drejta e parablerejs e parashikuar në këtë nen nuk respektohet, atëherë operacioni i kryer konsiderohet i pavlefshëm, me përjshtim të rastit kur ortakëve të cilëve u është mohuar kjo e drejtë japin miratimin e tyre të mëvonshëm në mënyrë shkresore.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.



Në rastin kur njëri prej ortakëve të shoqërisë vdes, kuotat e tij i kalojnë trashigimtarëve testamentar apo ligjor të ortakut trashëgimlënës.

Kuotat janë të papjestueshme. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

KREU IV **ORGANET E SHOQËRISË**

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori


Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 11 **KOMPETENCAT**

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Miraton ndarjen e fitimeve dhe dividendëve;



j) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 12

MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose ortakët e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 13

THIRRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën dhe orën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Procesverbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të Procesverbaleve.


Mbledhja e Asamblesë kryesohet nga Administratori i shoqërisë.

NENI 14

ORGANI ADMINISTRATIV

Shoqëria ka vetëm një Administrator. Administrator i parë i shoqërisë “**THINKSMART A & C**”

SH.P.K është Z.Egin Koçollari.



NENI 15

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron Administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit të tij është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportoj përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e organizimit të shoqërisë;
- marrë dhe shkarkojë nga puna personelin dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme në interes të shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

KREU V

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 16

Shoqëria "THINKSMART A & C " SH.P.K prishet:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa "Ne likujdim" qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj periudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimn e shoqerise prane QKR, pas shperndarjes se aktiveve te mbetura te shoqerise.

VITI FINANCIAR

NENI 17

Ne perputhje me ligjin shoqeria do te kete nje regjister ne te cilen mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.


NENI 18

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te po ketij viti, me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 Dhjetor.

FITIMET

NENI 19

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si fitim, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.



PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

NENI 20

NENSHKRIMI I KAPITALIT TE ORTAKËVE

Kapitali themeltar nenshkruset dhe ekzekutohet ne perputhje me kuotat si me poshte:

EGIN KOÇOLLARI	100 %	1 KUOTE	100,000 (njqind mije Lek)
-----------------------	--------------	----------------	----------------------------------

NENI 21

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij Statuti, dhe Aktit të Themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB), Tirane. Regjistrimi i kesaj Shoqerie ne QKR do te behet nga Administratori.

Shoqeria ka vulen e vete ne te cilen shkruhet emri i shoqerise sic e prashikon ligji.

Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale 4 në gjuhën shqipe me te njejten fuqi ligjore.

ORTAKU THEMELUES

Egin Koçollari

